

NJOFTIME FITUESI ME PROKURIM ELEKTRONIK

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 21.04.2017]

Për: Operatorin Ekonomik "Hastoci" shpk

Procedura e prokurimit: "Tender i Hapur" me objekt: "Rikonstruksion i tre rrugeve hyrese te qytetit Rrogozhine".

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksion i tre rrugeve hyrese te qytetit Rrogozhine".

Kohëzgjatja: brënda 5 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 124.996.999 (njëqind e njëzet e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH.

Fondi i akorduar për vitin 2017 është 24.999.400 (njëzet e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind) lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 30.03.2017.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	HASTOÇI	90,363,694
2	BIBA-X	93,745,215
3	ARKONSTUDIO	98,597,873
4	BOSHNJAKU. B	98,775,129
5	S I R E T A 2F	99,999,999
6	EUROTEOREMA PEQIN	100,000,000
7	BE - IS SH.P.K	103,288,514
8	"LALA"	106,166,601
9	G.P.G. COMPANY	109,156,160
10	VICTORIA INVEST	112,295,278
11	4 A-M	112,354,321
12	N.T.P. Eurokos-Dega ne Shqiperi	112,434,415
13	"SHKELQIMI 07"	NUK KA PARAQITUR OFERTE

14	ADEM POJANI	NUK KA PARAQITUR OFERTE
----	-------------	-------------------------

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Biba X” shpk (45%), dhe “Senka” shpk (55%) per arsye se:

Shoqeria “Senka” shpk nuk ploteson piken 2.3.7 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me mjetet dhe paisjet ne dispozicion. Ka marre persiper 55% te punimeve dhe ka vetem 2 kamioncina, 1 autobot dhe 1 autovinc. Nuk ka impiant betoni, vibratore betoni, autobetoniere, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punime betoni monolit.

Shoqeria “Biba X” shpk nuk ploteson Kerkesen per Kualifikim lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri pasi ka detyrime ne shumen 342.525 leke.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Arkonstudio” shpk (32%), dhe “Kthella” shpk (68%) per arsye se:

Per kontraten qe prokurohet shoqerise “Arkonstudio” shpk i takon te kryeje nje volum punimesh prej 31,551,319 lekesh pa tvsh. Vlera totale e punimeve qe duhet te kryeje shoqeria ”Arkonstudio” shpk nese shpallet fituese e kontrates qe shqyrtohet eshte 150.000.000 leke, nderkohe qe kjo shoqeri zoteron piken e licenses NP-4A e cila i lejon te kryeje ne te njejten kohe punime me vlere te pergjithshme jo me shume se 20.000.000 leke. Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi IIb kjo shoqeri duhet te skualifikohet.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Boshnjaku B” shpk (70.7%), dhe “Caushi” shpk (29.3%) per arsye se:

Shoqeria “Boshnjaku B” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Gjirokaster nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria “Caushi” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, nga viti 2016 ushtron aktivitet ne Kukes, Memaliaj, Peqin, Berat, Vrrine. Per keto objekte nuk ka paguar detyrimet vendore dhe nuk e ka regjistruar ne QKB. Per rrjedhoje edhe deklarata e paraqitur ne perputhje me kriterin 2.2.5 per kualifikim rezulton te jete e rreme.

Shoqeria “Caushi” shpk nuk ploteson piken 2.3.6 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve, pasi ka paraqitur dokumentacion per disponimin e nje mjeti autobetoniere, me targe AA145CZ, sipas kontrates se qerese lidhur me nr 1558 Rep dhe nr 263/1 Kol, te dates 19.04.2016, lidhur para noteres Ermira Rizaj. Te njejtin mjet shoqeria ”Ferro Beton” shpk ja ka dhene me qera shoqerise ”Garden Line” shpk” shpk me kontraten me nr 1176 Rep dhe nr 254 Kol lidhur me shoqerine ”Ferro Beton” shpk ne daten 27.02.2017 para noteres Xhevahire Brahja. Kontrata eshte fiktive me qellim plotesimin e kerkesave per kualifikim.

Te skualifikoje shoqerine “Euroteorema Peqin” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Milot – Lezhe - Rreshen nga viti 2011 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier ndertimi me profilin transport, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit.

Te skualifikoje shoqerine “Be - Is” shpk per arsye se:

Shoqeria “Be-Is” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Durres, Librazhd dhe Vlore nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore. Per rrjedhoje edhe deklarata e paraqitur ne perputhje me kriterin 2.2.5 per kualifikim rezulton te jete e rreme.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “NTP Eurokos” shpk (70%) dhe “Denisi 05” shpk (30%) per arsye se:

Shoqeria “NTP Eurokos” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier ndertimi me profil transport, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punime rrugore ne te cilat ky specialitet e shte i domosdoshem.

Te skualifikoje shoqerine “Shkelqimi 07” shpk e cila nuk ka paraqitur oferte.

Te skualifikoje shoqerine “Adem Pojani” shpk e cila nuk ka paraqitur oferte.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “Hastoci” shpk se oferta e paraqitur, me vlerë 90.363.694(nentedhjetë milion e treqind e gjashtedhjetë e tre mije e gjashtëqind e nentedhjetë e kater) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania

Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)

Fax: 00355 4 2 234 885

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.04.2017.

Per vleresimin nuk ka patur ankesa.